




M.6 prot
Dt. 05/02/2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 4, datë 31.01.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
NËNTOKËSOR PËR UJË TË PIJSHËM, TË “SHOQËRISË RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME POGRADEC” SH.A.,ME
VENDNDODHJE: FSHATI LIN, NJËSIA ADMINISTRATIVE
UDËNISHT, BASHKIA POGRADEC

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësorë për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës) në rastin kur përdorimi është > 1 l/sek, të “Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec” sh.a., me vendndodhje: Fshati Lin, Njësia Administrative Udënisht, Bashkia Pogradec.

2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit (KRGJSH):

X= 552626

Y= 4549035

Z=702 m.m.n.d

Sasia e ujit të kërkuar: $Q_{llog} = 20$ l/sek

Prurja mesatare vjetore: $Q_{\text{mes-vj}} = 70 \text{ l/sek}$

Prurja ekologjike: $Q_{\text{eko}} = 50 \text{ l/sek}$

Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji. Për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës).

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

